


Raport i

MONITORIMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR

korrik - dhjetor 2022



Проектот е финансиран
од Европската Унија



Институт за човекови права

Titulli:

RAPORT I MONITORIMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR
Për periudhën korrik - dhjetor 2022

Botues:

Shoqata e qytetarëve Instituti për të drejtat e njeriut Shkup

Shkup, dhjetor 2022

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

HYRJE



korrik - dhjetor
2022

Instituti për të Drejtat e Njeriut, nëpërmjet pranisë së tij në të gjitha sesionet e hapura, monitoron rregullisht punën e Këshillit Gjyqësor. Qëllimi i kësaj veprimtarie është që, nëpërmjet mbikëqyrjes objektive të punës së Këshillit, Instituti për të Drejtat e Njeriut t'i vërë në dukje sfidat dhe përparimin në punën e tij, si dhe të kontribuojë, me përfundime dhe rekomandime të bazuara në prova, në përmirësimin e gjendjes së gjyqësorit.

Raporti është i ndarë në tre pjesë kryesore, gjegjësisht që kanë të bëjnë me **transparencën**, **efektivitetin** dhe **efikasitetin** e Këshillit Gjyqësor.



Për nevojat e raportit u përdorën burimet e mëposhtme të informacionit: prania e të gjitha sesioneve të hapura të Këshillit Gjyqësor, procesverbalet dhe raportet e Këshillit Gjyqësor, dokumentet e publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të RMV- së, raportime në media etj.



TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR



mbajtur
19 seanca

Ka vazhduar prirja e publikimit të vazhdueshëm në kohë të **njoftimeve për mbajtjen e sesioneve dhe ajo e publikimit të një komunikate për vendimet dhe përfundimet e marra pas çdo seance.**

Detyrimi ligjor për të publikuar të dhënat e seancave të KGJRMV-së respektohet dhe procesverbalet, të cilat janë të detajuara, publikohen pas miratimit të tyre. Ndryshe nga periudha e mëparshme, **dinamika e adoptimit dhe publikimit të procesverbaleve është përmirësuar** dhe ato janë miratuar në seancat e radhës pa ndonjë vërejtje të madhe.

Ndërkohë, sistemi elektronik i regjistrimit të zërit dhe votimit është përsëri në funksion, që do të thotë se anëtarët votojnë nëpërmjet sistemit të votimit. Sipas rregullores së punës së KGJRMV-së, kjo është mënyra e rregullt e votimit dhe nëse ndonjë nga anëtarët dyshon për rezultatin atëherë ata mund të kërkojnë një votim me ngritje dore, që si mundësi u shfrytëzua në zgjedhjen e kryetarit të ri të KGJRMV-së me kërkesë të një anëtar, megjithëse nuk kishte vërejtje apo dyshime mbi korrektësinë e votimit nga anëtarët e tjerë.

Edhe pse **Raporti vjetor i punës i KGJRMV për vitin 2021** u dorëzua në Kuvend menjëherë pas miratimit të tij, ai ende nuk është shqyrtuar nga Kuvendi i RMV-së.

Mbetet vërejtja lidhur me atë që në të ardhmen Raporti Vjetor, përveç detaleve dhe të dhënave mbi gjyqtarët e përzgjedhur dhe të autorizuar, mbi korrektësinë kohore të gjykatave dhe të ngjashme, të përmbajë gjithashtu dhe të dhëna më të detajuara **mbi përmbushjen e Programit Vjetor të Punës si dhe mbi veprimtaritë e tjera të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, të cilat janë zbatuar por nuk kanë qenë pjesë e programit.** E gjithë kjo si një mënyrë për të dhënë pasqyrën e plotë të përmbushjes së Programit Vjetor me veprimtari të detajuara për çdo qëllim.

Edhe gjatë kësaj periudhe kohore, mund të shihet një dinamikë e ngjashme e mbajtjes së sesioneve në nivel mujor, ndërsa është evidentuar një rritje e numrit të seancave me më shumë pika për shqyrtim dhe vendimmarrje në periudhën pas zgjedhjes së kryetarit të ri, në dhjetor. Një sesion është gjithmonë i rezervuar për vendime lidhur me parashtresat e qytetarëve dhe personave juridikë, gjë që është dhe një detyrim ligjor.

Diçka e zakonshme për mënyrën se si punojnë anëtarët e Këshillit është mbajtja e kolegji-umeve, sidomos para se të mbahet një sesion publik. Në drejtim të efikasitetit më të madh, një herë në javë, mbahen takime pune të komiteteve për të diskutuar çështje që kanë të bëjnë me punën e përditshme të Këshillit Gjyqësor.

Për më tepër, mund të vihet re angazhimi i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe veprimtaria e tyre e vazhdueshme **në punën e Këshillit Gjyqësor nëpërmjet mendimeve, vërejtjeve dhe propozimeve.** Debati mbi çështjet e rendit të ditës zhvillohet me pjesëmarrjen e pothuajse çdo anëtari të Këshillit duke dhënë opinionin e tyre për një pikë të caktuar, duke përdorur të drejtën e një replike dhe argumente për ta arsyetuar atë. Këto interpretime të ndryshme janë tregues të konstruktivitetit dhe angazhimit të vazhdueshëm të anëtarëve, të rëndësishme për zhvillimin e debatit dhe marrjen e vendimeve të qëndrueshme.

Mund të vihet re një prirje pozitive në mënyrën se si zhvillohen sesionet krahasuar me praktikën e mëparshme.

Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të RMV (GJSRMV) brenda Këshillit janë anëtarë me post, por vazhdojnë që të ndjekin seancat shumë rrallë ose të mos jenë fare të pranishëm te to. Edhe në këtë raport, mund të vëmë re se prania e Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të GJSRMV-së do të ishte e rëndësishme, sidomos duke marrë parasysh se aktualisht po zhvillohet përgatitja e Strategjisë së Reformës në Drejtësi 2023-2027, andaj bashkëpunimi i tyre me Këshillin Gjyqësor është i nevojshëm për zbatimin e papenguar të reformave gjyqësore. Mund të vihet re një aktivitet mjaft i shtuar i anëtarëve të KGJRMV gjatë kësaj periudhe, përmes anëtarësimit në disa grupe pune që kanë të bëjnë me përgatitjen e Strategjisë së re, pastaj në grupin e punës që ka marrë pjesë në shqyrtimin dypalësh që u zhvillua më 1 dhe 2 dhjetor, 2022, ku u prezantuan aktivitetet e realizuara deri më tani, të cilat ishin të parapara me ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor. Gjithashtu vihen re aktivitetet e anëtarëve gjatë hartimit të Planit të Veprimit për parandalimin e korrupsionit, si dhe prania e tyre në ngjarje që kanë të bëjnë me Këshillin Gjyqësor dhe gjyqësorin në përgjithësi.



ANALIZA E PËRMBAJTJES SË NJOFTIMEVE DHE DEKLARATAVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR NË MEDIA

Nga monitorimi i faqes së internetit të Këshillit Gjyqësor, konstatohet se edhe në këtë periudhë ka **përshkrim më të detajuar** të pikave të rendit të ditës që janë diskutuar në seanca, si dhe како и **njoftime më të detajuara për mbledhjet dhe ngjarjet e ndjekura nga kryetari ose anëtarët e Këshillit gjyqësor.**



TË QENËT I HAPUR NDAJ PUBLIKUT DHE MEDIAS

Periudha në të cilën u monitorua puna e KGJRMV-së u shënua me zhvillime më domethënëse, prandaj edhe prezenca e publikut në këtë periudhë ishte më e madhe. Gjegjësisht, që nga fillimi i shtatorit, në Këshillin Gjyqësor ka pasur një numër të madh pikash interesante për të cilat janë interesuar gazetarët, kështu që përveç prezencës së vazhdueshme të përfaqësuesve të sektorit civil, ka pasur një prani më të shpeshtë **në seancat e gazetarëve që ndjekin dhe raportojnë për punën e KGJRMV-së.** Në periudhën e fundit, në disa media u shpërndanë informacione për punën KGJRMV-së, gjë e cila ka interes të madh nga publiku. Interes i veçantë lindi me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor në organet e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, pastaj me dorëheqjen e ish-kryetarit, zgjedhjen e kryetarit të ri etj. Me zgjedhjen e kryetares së re, prania e saj dhe e anëtarëve të tjerë në konferenca u rrit, kështu që mund të vihen re më shumë deklarata apo intervista të kryetares së re lidhur me aktualitete që kanë të bëjnë me gjyqësorin.

EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR



PËRZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR NGA RADHËT E GJYQTARËVE

Pas pensionimit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor më 1 korrik 2022, për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, është zhvilluar procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve nga Gjykata Supreme e RMV-së, zona e apelit Shkup me gjykatat administrative dhe zonën e apelit në Gostivar. Sa u përket kandidatëve, mund të thuhet se në zonën zgjedhore të Gjykatës Supreme është paraqitur vetëm një kandidat, gjyqtarja Mirjana Radevska Stefkova, në zonën zgjedhore të apelit Shkup dhe gjykatat administrative është paraqitur sërish vetëm një kandidat, gjyqtari i Gjykatës së Apelit në Shkup, Zoran Gerasimovski, ndërsa në zonën zgjedhore të Gostivarit ishin paraqitur dy kandidatë - gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Tetovës, Ljupço Spiroski dhe Ivica Nikolovski.

Me rastin e përcaktimit të kandidaturave të gjyqtarëve-kandidatëve të paraqitur, Këshilli Gjyqësor ka diskutuar rreth pacaktueshmërisë në Ligjin për Këshillin Gjyqësor në lidhje me dokumentet që duhet të dorëzohet çdo kandidat që aplikon pas shpalljes së publikuar për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor. Gjegjesisht, disa nga anëtarët ishin të mendimit se pavarësisht se ligji përcakton se cilat dokumente duhet të paraqesë kandidati, kjo nuk është e nevojshme sepse Këshilli Gjyqësor ka informacion për secilin gjyqtar, të dhëna tashmë të njohura për ta, që janë pjesë përbërëse e dosjeve të çdo gjyqtari dhe për këtë arsye nuk duhen kërkuar për dorëzim. Nga ana tjetër, një pjesë e anëtarëve mendojnë se pavarësisht se Këshilli Gjyqësor është i familiarizuar me të dhënat që duhet të dorëzohen me rastin e aplikimit për një konkurs specifik, çdo kandidat është megjithatë i detyruar ta bëjë këtë, pasi është detyrim ligjor.

Kështu, anëtarët e Këshillit Gjyqësor kanë pasur një qasje jokonsistente në lidhje me dokumentet e nevojshme kur është dashur të zgjidhet kryetari i Gjykatës së Apelit në Shkup dhe për këtë arsye kjo shpallje është përsëritur sepse kandidati i vetëm nuk i kishte dorëzuar të gjitha dokumentet e shënuara në ligj, edhe pse ato mund të kenë qenë të njohura nga anëtarët e Këshillit. Aq më tepër që edhe në shpalljet për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave nuk ishin specifikuar dokumentet që duhej të dorëzoheshin kandidatët.

Pas zgjedhjeve të mbajtura, më 15 shtator 2022, nga radhët e gjyqtarëve u zgjodhën tre anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor. Si anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor ishin: Mirjana Radevska Stefkova, gjyqtare nga zona zgjedhore e Gjykatës Supreme të RMV; Zoran Gerasimovski, gjyqtar nga Gjykata e Apelit Shkup dhe kontestet administrative; Ivica Nikolovski, gjyqtar nga Gjykata e Apelit në Gostivar. Procedura e zgjedhjeve është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore, duke përfshirë respektimin e dispozitës për publikimin e rezultateve të zgjedhjeve, e cila është bërë duke vendosur video-incizim të numërimit të votave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor.



ZGJEDHJA E KRYETARIT TË RI TË KGJRMV-SË

Më 29 nëntor 2022, në seancën e rregullt të Këshillit, kryetarja Pavlina Cërvenkovska dorëzoi dorëheqje të parevokueshme nga pozita e kryetares së Këshillit Gjyqësor, dhe siç tha vetë, arsyeja për këtë është se zgjedhja e saj për kryetare nuk i është përshtatur grupit të elitës gjyqësore-biznesore dhe nga ana e tyre ka nisur një ndjekje mediatike, e gjitha me synimin që ajo të tërhiqet nga posti përkatës. Përkundër faktit se anëtarët e Këshillit Gjyqësor i kërkuan kryetares së dorëhequr të sqaronte akuzat që ajo bëri në dorëheqjen e saj me shkrim para publikut, ajo bëri veshin shurdh ndaj këtyre kërkesave dhe nuk u sqaroi kolegëve se cilat janë ato elita gjyqësore-biznesore që kanë ndikuar në punën e saj. Ky është rasti i parë që nga ekzistenca e Këshillit Gjyqësor, që kryetari jep dorëheqjen me iniciativë të tij. Mund të thuhet se nuk ka pasur përvojë të tillë as në mesin e anëtarëve të Këshillit, përveç një anëtari të zgjedhur nga Kuvendi i RMV-së, i cili dha dorëheqje në maj të vitit 2020 pas zgjedhjes së Pavlina Cërvenkovskës për kryetare të KGJRMV-së.

Më 5 dhjetor 2022 u bë zgjedhja e kryetarit të Këshillit Gjyqësor. Me propozim të një anëtari të Këshillit Gjyqësor, u zgjodh Vesna Dameva, anëtare e Këshillit të Gjykatës të RMV me 11 vota “për” dhe një “kundër”. Vesna Dameva, si kryetare e sapozgjedhur e Këshillit Gjyqësor, në fjalimin e saj para opinionit theksoi se do të luftojë në radhë të parë kundër korrupsionit në gjyqësor, “për çdo gjyqtar korrupsioni i të cilit do të konstatohet me prova dhe fakte, nuk do të ketë vend për një shans të dytë, thjesht do t’u vihet në dukje se persona të tillë nuk meritojnë të mbajnë detyrën e gjyqtarit.”

ΓNjë pakënaqësi e madhe nga ana e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor është vënë re në seancën e rregullt të mbajtur më 24 nëntor 2022. Kjo pakënaqësi ka pasë për bazë mënyrën se si janë propozuar kandidatët për anëtarë të organeve të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë nga kryetarja Cërvenkovska, si dhe raportin me kandidatët për anëtarë, sepse një pjesë e madhe e kandidatëve të propozuar janë ende mentorë në këtë Akademi, gjë kjo që paraqet pengesë ligjore që ata të zgjidhen anëtarë të organeve të Akademisë. Pas votimit, në të cilin të gjithë kandidatët e propozuar nga kryetarja Cërvenkovska nuk morën shumicën e nevojshme, anëtarët e Këshillit Gjyqësor propozuan kandidatë për anëtarë të organeve të Akademisë. Për anëtarë të organeve të Akademisë u votuan të gjithë kandidatët e propozuar nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor. Mes të zgjedhurve u zgjodh edhe një anëtar i Këshillit Gjyqësor, i cili shkaktoi reagime të stuhishme në opinion për përqëndrimin e funksioneve në një person. Nuk ka asnjë pengesë ligjore për këtë lloj veprimi, por për shkak të konfliktit të interesave nuk këshillohet që një anëtar i Këshillit Gjyqësor të jetë anëtar i Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Aq më tepër që i njëjti anëtar u propozua dhe u zgjodh njëzëri Drejtor Ekzekutiv i Akademisë, kështu pas udhëzimeve nga KSHPK dhe për arsye personale, ky anëtar dha dorëheqjen nga ajo detyrë vetëm pas një dite.



PËRZGJEDHJA E GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE/VLERËSIMI I GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Gjatë kësaj periudhe raportuese (korrik-dhjetor 2022) Këshilli Gjyqësor i RMV-së zgjodhi gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave pas një periudhe të gjatë kohore dhe një nga arsyet e vonesës së zgjedhjeve ishte kohëzgjatja e procedurës për vlerësimin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, që lidhet drejtpërdrejt me përzgjedhjen, pra përparimin e tyre

Përkatësisht, gjatë muajit shtator ka filluar vlerësimi i gjyqtarëve, i cili është një proces mjaft i ndërlikuar dhe me shumë faza. Krahas vlerësimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave nga komisionet e përbëra nga gjyqtarë, fazën përfundimtare të vlerësimit e kryen një komision i përbërë nga anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Që kur Këshilli Gjyqësor e zyrtarizoi këtë proces duke miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe krijimin e komisioneve, pasoi një proces i përmirësimit të AKMIS-it në mënyrë që rastet të përcaktoheshin rastësisht për t'u vlerësuar nga komisionet. Pas përfundimit të vlerësimit, pasoi një periudhë e zgjidhjes së ankesave të paraqitura nga gjyqtarët e pakënaqur dhe përsëritjes së procedurës për ata që i pranuan ankesat, kështu që i gjithë procesi përfundoi gjatë muajit dhjetor, gjë që plotësonte kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve/kryetarëve të gjykatave.

Në periudhën e përmendur u zgjodhën ushtrues detyre të Gjykatës së Apelit në Shkup, të Apelit në Shtip, në Gjykatën Themelore të Manastirit dhe në Gjykatën Themelore të Krushevës, për shkak se nuk ishin krijuar kushte për kryerjen e zgjedhjeve të rregullta të kryetarëve pas njoftimeve të publikuara.

Mirëpo, në fund të dhjetorit, pas procesit të vlerësimit të kandidatëve për kryetarë gjykatash, u zgjodhën kryetarë gjykatash në Gjykatën Themelore Penale të Shkupit, në Gjykatën Themelore të Resnjës dhe në Gjykatën Themelore të Vinicës, përkatësisht:

- Kryetar i Gjykatës Themelore Penale Shkup është zgjedhur Ivan Jolev, gjyqtar në Gjykatën Themelore Penale Shkup;
- Kryetar i Gjykatës Themelore Resnjë është zgjedhur Emelj Kranli Ali, gjyqtar në Gjykatën Themelore Resnjë.
- Kryetare e Gjykatës Themelore të Vinicës është zgjedhur Susana Spasova, gjyqtare në Gjykatën Themelore të Koçanit;

Gjyqtarë u zgjodhën edhe në Gjykatën Themelore Penale Shkup dhe në Gjykatën Themelore Shtip, gjegjësisht gjyqtar në Gjykatën Themelore Penale Shkup iu zgjodh Branka Naumoska- gjyqtare e Gjykatës Themelore Kumanovë, ndërsa gjyqtar i Gjykatës Themelore Shtip u zgjodh Todor Pop Panev-gjyqtar në Gjykatën Themelore të Sveti Nikoles. Kjo mundësi është paraparë në Ligjin për Këshillin Gjyqësor¹, ku thuhet se Këshilli mund të zgjedhë gjyqtarin e një gjykate themelore, i cili ka aplikuar në shpalljen për gjyqtar të një gjykate tjetër themelore nëse nuk ka kandidat nga Akademia e Gjyqtarëve dhe në shpallje kanë aplikuar prokurorë publikë. Meqenëse në kohën e publikimit të shpalljeve për këto pozita gjyqtarësh në gjykatat themelore nuk kishte kandidatë të gjeneratës së 7-të, Këshilli Gjyqësor zgjodhi gjyqtarë aktivë nga gjykatat tjera themelore dhe në një farë mënyre është bërë transferimi i gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetrën.

¹ Neni 47 paragrafi 6 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 102/2019)

Duke pasur parasysh se kjo ishte zgjedhja e parë e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave sipas Metodologjisë së re të Vlerësimit, Kryetari i Këshillit Gjyqësor si dhe anëtarët e Komisionit që bënë vlerësimin përfundimtar, pikërisht në seancën ku morën pjesë një numër i madh i përfaqësuesve të medias, shpjegoi në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit, duke treguar të gjitha fazat në të cilat merret nota përfundimtare. Ata theksuan veçanërisht elementin objektiv të kësaj metode vlerësimi, duke pasur parasysh se janë të përfshirë gjyqtarë dhe anëtarë të Këshillit Gjyqësor, të cilët vlerësojnë kriteret cilësore dhe sasiore në faza të ndryshme, duke shmangur kështu elementin subjektiv në vlerësim. Por me gjithë pritshmëritë e mëdha nga publiku, ende mungonin shpjegimet më të detajuara të notave individuale sipas kriterëve cilësore dhe sasiore të përcaktuara në vetë ligjin dhe në aktet e shumta nënligjore që janë hartuar prej kohësh. **Edhe pse vlerësimi është një proces i padisponueshëm për publikun, për të përmbushur pritshmëritë, Këshilli Gjyqësor duhet të kishte komunikuar më në detaje vlerësimet për secilin kandidat individualisht për të realizuar “sistemin e meritave”** që duhej të siguronte vlerësim të paanshëm dhe të drejtë dhe zhvillim të mëtejshëm profesional të gjyqtarëve, bazuar në aftësitë e tyre personale dhe profesionale pa asnjë ndikim, si dhe përforcim i pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor.



SHKARKIMI I GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Në periudhën deri në dhjetor 2022, Këshilli Gjyqësor ka 2 gjyqtarë nga Gjykata Themelore e Tetovës dhe Gjykata Themelore e Shtipit.

Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor konstatoi ndërprerjen e funksionit gjyqësor për shkak të daljes në pension të 14 gjyqtarëve, gjë që rriti mungesën e gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe të apelit.



MONITORIMI I PUNËS SË GJYKATAVE

Monitorimi i punës së gjykatave kryhet nga KGJRMV përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të raporteve tremujore dhe vjetore për punën e gjykatave, por edhe nëpërmjet vizitave në gjykata nga komisionet e përbëra nga anëtarë të Këshillit Gjyqësor, që parashikohet në Planin e Brendshëm për monitorim dhe vlerësim të punës së gjykatave, gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave për vitin 2022.

Nga raportet tremujore për punën e gjykatave, mund të konstatohet se trendi i gjykatave jo të përditësuara vazhdon dhe arsye për këtë gjendje janë zvogëlimi i numrit të gjyqtarëve, numri i pamjaftueshëm i administratës gjyqësore, rritja e numrit të lëndëve, por edhe pushimet vjetore të gjyqësorit.

Është praktikë e zakonshme që pas vizitave në gjykata, anëtarët e komisionit që ka kryer vizitën e seancës, ta prezantojnë raportin e vizitës, duke evidentuar gjetjet më domethënëse që kanë arritur dhe duke propozuar konkluzione për veprime të mëtejshme nëse ka mangësi në funksionimin e gjykatave ose të disa gjyqtarëve apo kryetarëve të gjykatave.

Kryetarja e re, në njërin prej seancave, propozoi dhe u arrit një përfundim që raportet tremujore të dorëzuara nga gjykatat drejt KGJRMV duhet të përmbajnë më shumë informacion në lidhje me punën e gjykatave, si dhe në lidhje me sfidat me të cilat ballafaqohen,

si për shembull shkaqet për vjetërimin e lëndëve duke prezantuar plan veprimi për zgjidhjen e tyre dhe informacione të tjera. Në këtë drejtim, KGJRMV miratoi një Plan të Brendshëm për monitorimin e punës së gjykatave, gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, i cili parasheh vizita më të shpeshta në gjykata nga anëtarët e KGJRMV-së, për të parandaluar disa situata që janë me interes për publikun dhe qytetarët e RMV. Është miratuar edhe orari i punës së Këshillit Gjyqësor të RMV për vitin 2023. Për hir të zbatimit sa më efektiv të këtyre akteve, Këshilli Gjyqësor ka miratuar një Konkluzion, me të cilin detyrohen të gjithë koordinatorët e gjykatave që të bëjnë vizita pune në gjykata, duke vënë theks të veçantë në lëndët e vjetra.

Këshilli Gjyqësor i RMV-së në drejtim të angazhimit të tij në luftën kundër korrupsionit si dhe për përmbushjen e detyrimit nga Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit miratoi Programin dhe Planin e Veprimit për parandalimin dhe monitorimin e korrupsionit në gjyqësor, i cili u prezantua publikisht. Është miratuar edhe Kodi i Etikës për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të RMV-së.

Programi për punën e Këshillit Gjyqësor të RMV-së për vitin 2023 është miratuar në afatin e paraparë ligjor, si dhe janë miratuar ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të RMV-së, ku janë specifikuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të një gjykate.



VENDIMARRJA RRETH PARASHTRESAVE TË QYTETARËVE DHE PERSONAVE JURIDIKË

Parashtresat e qytetarëve dhe personave juridikë, të cilat i dorëzohen KGJRMV-së, dhe i referohen punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, shqyrtohen dhe zgjidhen rregullisht në përputhje me afatet ligjore.

Në gjysmën e dytë të vitit 2022 janë shqyrtuar rreth 195 parashtresa të dorëzuara nga qytetarët dhe personat juridikë.

Këshilli Gjyqësor hedh poshtë si të pabaza numrin më të madh të parashtresave, duke pasur parasysh se me anë të parashtresave qytetarët, pra personat juridikë kërkojnë ndryshimin e vendimit të gjykatës, ngaqë nuk janë të kënaqur me të. Në shumicën e rasteve, Këshilli Gjyqësor konstaton se procedimi i çështjes bazohet në ankim në gjykatën e shkallës së dytë, kështu që gjykata e shkallës së dytë do t'i vlerësojë pretendimet në parashtresë si pretendime ankimore në procesin e vendimmarrjes, dhe si rrjedhojë **nuk ka kompetencë të ndërhyjë në vendime gjyqësore, as t'i ndryshojë ato, duke mos konstatuar arsye për veprim.**

Mund të vihet re edhe refuzimi i parashtresave dhe arsyet kryesore për refuzimin e tyre janë: mungesa e fakteve të reja në lidhje me parashtresën e paraqitur, shqyrtimi paraprak i parashtresës në një nga seancat e mëparshme ose për shkak se parashtresa nuk i përmban të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për t'u rishikuar.

Këshilli Gjyqësor konstaton se një numër shumë i vogël i parashtresave janë të bazuara dhe në këtë rast konstatimet do të jenë pjesë e vlerësimit të gjyqtarit ndaj të cilit është paraqitur parashtresa dhe arsyet e paraqitura në parashtresë nuk janë të mjaftueshme për fillimin e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarit në fjalë.

REKOMANDIME

Bazuar në monitorimin e seancave të hapura të Këshillit Gjyqësor, raporteve për Këshillin Gjyqësor, njoftimeve dhe dokumenteve të publikuara në faqen e Këshillit Gjyqësor të RMV-së, raportimeve të mediave, mund të rekomandohen:



Në periudhën në vijim, Këshilli Gjyqësor duhet t'i drejtojë kapacitetet e tij drejt rritjes së besimit të qytetarëve në gjyqësor, përmes një roli proaktiv dhe marrjen e masave për uljen e perceptimit të ekzistimit të korrupsionit në gjyqësor, me rritjen e bashkëpunimit me të gjitha institucionet që punojnë në këtë fushë dhe me adresim më të shpeshtë ndaj publikut të gjerë.



Pavarësisht se në Programin dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Monitorimin e Korrupsionit në Gjyqësor nuk ka një kornizë kohore më specifike, është e nevojshme që Këshilli Gjyqësor të informojë më shpesh publikun për zbatimin e këtyre aktiviteteve dhe masave, me qëllim rritjen e besimit në gjyqësor dhe në vetë Këshillin Gjyqësor, si organ përgjegjës për t'u kujdesur për reputacionin e gjyqtarëve dhe besimin e qytetarëve në gjyqësor.



Besimi te Këshilli Gjyqësor duhet të rritet dhe te vetë gjyqtarët, që është dukshëm në një nivel më të ulët, gjë që tregohet nga interesi i ulët i gjyqtarëve për t'u kandiduar për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, duke pasur parasysh se për çdo vend vakant për anëtar të Këshillit Gjyqësor, ka pasur vetëm një kandidat të interesuar, duke mos lejuar kështu konkurrencën ndërmjet gjyqtarëve për të zgjedhur midis shumë kandidatëve.



Në drejtim të sigurimit të transparencës më të madhe dhe rritjes së besimit të qytetarëve në objektivitetin e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, është e nevojshme që vendimet e përzgjedhjes të përmbajnë informacion më të detajuar, gjë që do të pasqyrojë metodologjinë e re dhe do të tregojë në mënyrë adekuate pse një kandidat i caktuar është zgjedhur mbi një tjetër.

